

ANILA OMARI

**HUAZIMET TURKE NË LEKSIKUN
E CUNEUS PROPHETARUM TË BOGDANIT**

Në kuadrin e një analize të leksikut të veprës së Pjetër Bogdanit *Cuneus Prophetarum* sipas shtrezësimit tipologjik të tij, me synim evidentimin e pasurisë leksikore të kësaj vepre në krahasim me tekstet paraardhëse, jemi ndalur në huazimet leksikore nga gjuhët e tjera, që përbëjnë një nga shtresat e rëndësishme të leksikut të kësaj vepre madhore të shekullit XVII. Huazimet kanë qenë një nga rrugët kryesore të pasurimit të leksikut të shqipes që nga fillimi i shkrimit të shqipes e deri në kohën e sotme.

Si një vepër jo vetëm e vëllimshme por edhe shumëpërmasore e me tematikë të larmishme, vepra e Bogdanit përmban një fjalor më të pasur se veprat e shkrimtarëve paraardhës të shqipes së vjetër, me një sasi prej rreth 4290 lemashe. Leksiku i veprës së Bogdanit është më i pasur nga paraardhësit edhe për sa u përket huazimeve. Niveli intelektual e shkencor i veprës së tij kërkonte fjalë e terma të rinj, të cilët gjuha shqipe nuk arrinte t'i mbulonte "me petëkun e shqerrë të saj". Bogdani është i ndërgjegjshëm për mangësitë e gjuhës shqipe si një shkak për huazimet e saj nga gjuhët e tjera¹. Një nga rrugët e pasurimit të gjuhës letrare të tij me fjalë të leksikut abstrakt e dituror ka qenë pikërisht huazimi.

Huazimet leksikore në tekstin e Bogdanit mund të ndahen në huazime popullore, ku hyjnë turqizmat, sllavizmat dhe italianizmat popullore, zakonisht me karakter venecian, dhe huazime librore ose diturore, që janë kryesisht italianizma dhe latinizma. Në këtë kumtesë jemi ndalur në turqizmat e veprës së Bogdanit, në krahasim edhe me ato të autorëve paraardhës. Në shekullin XVII turqizmat kanë ardhur duke u shtuar dhe ngulitur në gjuhë bashkë me konsolidimin e pushtetit osman dhe depërtimin e kulturës dhe gjuhës turke, dhe kjo gjendje reflektohet edhe në gjuhën e tekstit të Bogdanit.

¹ "...unë tue vum roe të gjymtët' e giuhësë arbëneshe, e silla për të pakë~të vet të madhe pjesë huan giuhëshit konfinjëtare,..."

Në shtresëzimin e huazimeve leksikore në tekstin e Bogdanit huazimet turke zënë vendin e dytë në pikëpamje sasiore me 87 njësi, mbas italianizmave me 230 njësi leksikore. Në tekstet e vjetra deri te Bogdani ne mund të ndjekim përparimin e depërtimit të turqizmave në letërsi në shekujt XVI-XVII, nga një autor në tjetrin. Buzuku (1555) përdor një numër shumë të kufizuar prej rreth 5 leksemash me burim të drejtpërdrejtë nga turqishtja: *akshand* “agu i ditës, mëngjes herët, mug”², *dollamë*, *harami* “kusar”, *kallaus*, *tepsi*, ndoshta edhe *pajë* “trashëgimi; pjesë”³; Budi (1618, 1621) rreth 10 leksema: *begënis*, *me dertunë* “vajtoj” prej turq. *dert*, *hesap*, *maskarī* prej turq. *maskara*, *pajë* “hatër, anë” prej turq. *pay* “pjesë, dasik, porcion”, *pazar*, *raki*, *shend* “gëzim”, *taminqār* “i matur” prej turq. *tahmin*, *terezī* “peshore”, *senxhir*⁴, ndërkohë që numri i

² Ky kuptim (*mug* “gjysmerrësira para mbrëmjes ose agimit”) duhet të jetë domethënia e kësaj fjale në shqipen e autorëve të vjetër (Buzuku: *porsi akshandi i dritësë qi ngrihetë ndënatanet* LVII/2=LXVII/2, Bardhi: *Aurora Akshani i dritësë, ò ndenateja* 7 22, Kuvendi i Arbënit: *akshani i dritese* 36 19), që i afrohet kuptimit të turqishtes dhe të shqipes së sotme *aksham* “mbrëmje”. Me këtë shmangen vështirësitë që sjell kuptimi “agim, shkëlqim” që jep Çabej (SE II, f. 30), i cili për arsye kuptimore nuk pranon një huazim nga turqishtja.

³ Meriton një diskutim më të gjerë çështja nëse *pajë* I “plaçkat dhe pasuria që merrte me vete nusja e i çonte në shtëpinë e dhëndrit kur martohej” dhe *pajë* II “përkrahje e dikujt kur nuk ka të drejtë, anësi, anë, hatër” (FGJSSH) janë në origjinë dy fjalë të ndryshme apo një e vetme. Çabej i merr si dy fjalë më vete, të parën, fjalë e mbarë gjuhës, e rrjedhon, me Meyerin, prej lat. *pallium*, kurse të dytën, fjalë e gegërishtes, prej turq. *pay* “pjesë, dasik, porcion” (SE VI, f. 116-117). Në librin e tij të porsadalë nga shtypi *Die sekundären Wortbildungsmuster im Altalbanischen bei Gjon Buzuku*, Harrassowitz, Wiesbaden, 2016, f. 50, Joachim Matzinger e merr *pajë*-n si një fjalë të vetme, me kuptimet “trashëgimi, pjesë”, dhe e rendit ndër turqizmat e Buzukut, Budit e Bardhit, pasi dokumentohet te të tre këta autorë. Nga ana kuptimore, *pajë* I dhe *pajë* II bashkohen në disa përbërës semantikë të tyre me kuptimin “pjesë që i takon dikujt” që ka fjala turke *pay*. Por nga ana tjetër, ekzistenca e *-l*-së ndërzanore në variantin *palë* të tosk. jugore të Gjirokastrës dhe të çamërishtes flet për një **li9* > *lj* të dikurshme, e cila në këto të folme ka kaluar në *l*, ndërsa në mbarë gjuhën është spirantizuar në *j*. Veç kësaj, në tosk. jugore turqizmat marrin theks fundor, jo parafundor. Këto të dhëna flasin për një vjetërsi më të madhe të fjalës *pajë* I dhe e ndajnë fonetikiht nga *pajë* II, duke i dhënë të drejtë Çabejt, i cili i ndan edhe kuptimisht këto fjalë dhe nuk e afron *pajë* I me turqishten.

⁴ Në këtë grup fjalësh të Buzukut dhe të Budit nuk kemi llogaritur disa syresh që kanë hyrë nëpërmjet gjuhëve të tjera ballkanike, si greqishtes së re (*cohë*),

turqizimave shtohet shumë në fjalorin e Frang Bardhit (1635), me 47 njësi leksikore. Turqizma të Bardhit⁵ janë: *aferim, akshan, allah, bajrak, berber, biber, çisme, çoban, davëxhî* “grindavec, lat. litigator”, *davî* “grindje, zënkë”, *dert, deve, elçî* “lajmëtar, i dërguar, lat. legatus”, *hain, hakshî* “kuzhinier, akçi, lat. cocus”, *hambar, haraç, hesap, hiç, hodë, horriat, ibrik, kallauz, kamare, kazan, kurban, lojlek* “lejlek”, *maskara, mireqep* “bojë shkrimi, lat. atramentum”, *nozullë* “ushqime udhëtimi, it. vettovaglia”, *okë, pajë* “anë” (*me mbajtunë pajë* “defendere” 18 5; *ata gj mbajnë pajë* “sequaces” 149 27; 177 12 etj.), *pazar, perçe, qemal* “lat. praeco,-nis, lajmëtar, tellall”, *qendî* “iqindi, mbasdite”, *qervasare* “lat. taberna, dyqan i vogël, pijetore” nga turq. *kervansaray, qyrshî* “qyrkxhi”, *rajë, sanxhak, senxhir, tepsi, tesqere, xhambaz, dylber* “ylber”, *ylefë* “rrogë”, *zagar*⁶. Bardhi në shpjegimin e fjalëve latine, në vend të shpjegimit shqip, në disa raste jep fjalën gjegjëse turke, ose krahas fjalës shqipe edhe gjegjësen turke, si psh. për Apparitor: turcice *çaush* (f. 6), për iudex: gjykues, turcice *kadi* (f. 43), cerebrum: mend, turcice *bein*; christianus: I kërshenë, turcice *giaur* (f. 11), cochlearium: lugë, turcice *kassik* (f. 13), dives, ricco: i begatë, turcice *devolet* (f. 20), epirote: i arbëneshë, turcice *Arnautlar* (f. 22). Turqishtja është njëra nga katër gjuhët në të cilat jepen emrat e faefisnisë, veç latinishtes, italishtes dhe shqipes: filius: bër, turqisht *oglan* (f. 194); pater: tatë, *baba*; avus: tatagjysh, *atta*; proavus: skatragjysh, *dede*; frater: vëllë, *cardasc*; consobrinus: kushërri, *amuga* (f. 194); soror, sorella: motra; *kiskardasch* (f. 195), sponsa, sposa: nuseja; *gelin* (f. 195) etj.

Vendi që zë përdorimi i turqishtes në fjalorin e Bardhit dëshmon edhe për shkallën e njohjes së turqishtes, të paktën në rrethet intelektuale

serbishtes (*tekë* “sapo; vetëm, vetëm sa”), serbishtes/greqishtes (*temel/themel*) të cilave vetë Çabej ua saktëson burimin e drejtpërdrejtë. Shih për këto: E. Çabej, “Për një shtresëzim kronologjik të huazimeve turke të shqipes”, *Studime Filologjike*, nr. 4, 1975, f. 83 v.; A. Kostallari, “Rreth depërtimit të turqizimave në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII”, në: *Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve* III, f. 94-95.

⁵ Vjelja e turqizimave të Frang Bardhit është bërë nga botimi kritik i B. Demirajt, *Dictionarium Latino-Epiroticum (Romae 1635) per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.

⁶ Shih dhe A. Omari, “Bardhyl Demiraj, *Dictionarium Latino-Epiroticum (Romae 1635) per R.D. Franciscum Blanchum*”, Botime Françeskane, Shkodër, 2008, në *Perla* revistë shkencore-kulturore, Viti XIV 2009, nr. 2 (53), f.125-130; A. Kostallari, art. i cit., *Studime mbi leksikon*, f. 94.

qytetare, në kohën e tij. Me shumë gjasë ai vetë si intelektual që njihte disa gjuhë të rëndësishme kulturore të kohës, duhet ta ketë njohur edhe turqishten, si gjuhë zyrtare e Perandorisë ku bënë pjesë trojet shqiptare. Për Pjetër Bogdanin kemi të dhëna të sigurta prej atij vetë se e fliste fare mirë këtë gjuhë, krahas njohjes me shkrim e me gojë të gjuhës serbo-kroate (ilirike).⁷ Me sa duket, gjatë sundimit osman në trojet shqiptare ishte përhapur gjerësisht dygjuhësia me turqishten si gjuhë zyrtare e Perandorisë, siç dëshmon ende në fillim të shekullit XX Faik Konica për doganierët e doganës së Durrësit që flisnin një turqishte gjysmake me njëri-tjetrin (“Shqipëria si m’u duk”).

Edhe Dorëshkrimi i Grottaferratës i vitit 1710 përmban në pjesën e dytë të tij një traktat mbi gjuhën turke: “Trattatello sopra la lingua turchesca” si dhe një fjalor italisht-turqisht: “Dittionario italiano et turchesco per alfabeto”. Ka edhe pak të dhëna për arabishten, kryesisht në fushën e alfabetit.⁸

Gjendja e turqizimeve në tekstin e Bogdanit na jep një orientim të përafërt për shkallën e depërtimit të tyre në gjuhën shqipe në fund të shekullit XVII, duke pasur parasysh që kemi të bëjmë me një vepër letrare me karakter të ngritur dituror dhe me përmbajtje fetare katolike, çka parakupton apriori një numër më të vogël të turqizimeve në krahasim me gjendjen e përdorimit të tyre në gjuhën e folur. Për më tepër, shkrimtarët e vjetër, në një situatë politiko-gjuhësore që të kujton Rilindasit, ishin mjaft të ndjeshëm ndaj dukurisë së depërtimit të turqizimeve në gjuhë, për çka aludonin vazhdimisht në parathëniet e veprave të tyre duke u ankuar për “bastardimin” e gjuhës apo për humbjen e fjalëve të vjetra shqipe (“të mos dvärenë fjalëtë, të sillatë sa e kanë po ntretënë”, Bogdani, Të primitë XV). Ata vetë u angazhuan në përdorimin e një gjuhe mundësisht “të pastër” nga turqizmat, duke u përpjekur të rigjallëronin leksikun e vjetruar të shqipes, siç pohon Bogdani për mundimin e tij “me qitunë mbë dritë shumë fjalë plaka e të harrueme” dhe për zellin e tij për t’i përdorur ato (“tue votë unë mbas disa fjalësh plaka, të mos harrohej e të dvarej giuha”). Në shekujt e

⁷ Khs. në një letër të tijën të vitit 1674 drejtuar Kongregatës së Propagandës Fide: “Adopro contra l’alcorano in molti punti li Padri Malvasia e Guadagnioli con portarli in lingua turchesca et illirica, havendo io cognitione anche a leggere e scrivere il carattere del ultima oltre il parlar perfettamente la prima...”, në O. Marquet, *Pjetër Bogdani. Letra dhe dokumente*, Sh.B. At Gjergj Fishta, Shkodër, 1997, f. 279.

⁸ Khs. T. Osmani, “Gramatika shqipe e 1710: A është vërtet ajo e para?”, *Gazeta Shqiptare*, 3 maj 2010.

mëpasëm, bashkë me konsolidimin e sundimit osman dhe përparimin e islamizimit, përdorimi i turqizmeve do të vijë duke u rritur progresivisht në të folmet e Veriut, veçanërisht në të folmen e qytetit të Shkodrës, siç mund të konstatohet qysh në fjalorin shqip-italisht të Da Lecces (1702) me një numër turqizmesh prej rreth 350 njësisish leksikore në një korpus leksikor prej rreth 6000 njësisish⁹ e, një shekull e gjysmë më vonë, te shkrimtarët e traditës letrare shkodrane të mesit të shekullit XIX, si Pjetër Zarishi, Engjëll Radoja, Leonardo de Martino, Ndue Bytyçi, Pashko Babi etj.

Turqizmat që përmban teksti i Bogdanit, 87 njësi leksikore, i kemi klasifikuar sipas fushave leksikore ku kanë depërtuar, për të krijuar një ide më të qartë jo vetëm për shtrirjen por edhe për peshën specifike të tyre në leksikon e shqipes së shek. XVII. Siç e ka theksuar Çabej, shpërndarja e huazimeve turke në fushat e veprimtarisë dhe në sferat e ndryshme të jetës ka rëndësi edhe në pikëpamje të historisë së kulturës shqiptare¹⁰. Ndarja mbështetet në klasifikimin e dhënë për turqizmat e shqipes nga Pellegrini-Mandalà¹¹, me disa ndryshime e plotësime në përputhje me lëndën që ofron teksti. Secila nga leksemat e përfshira në listë është konfirmuar si turqizëm duke u përqasur me fjalorin e orientalizmeve të Tahir Dizdarit¹², me fjalorin etimologjik të Gustav Meyerit¹³ si dhe me Studimet etimologjike të Çabejt¹⁴. Shumica e turqizmeve, 75 njësi leksikore, dalin për herë të parë të Bogdani. Fjalët që gjenden edhe te autorët paraardhës janë shoqëruar me emrin e autorit përkatës. Në listë kemi përfshirë vetëm turqizmat e mirëfilltë, të hyrë në shqipe drejtpërdrejt nga kontaktet gjuhësore me turqishten dhe jo nëpërmjet ndonjë gjuhe tjetër ndërmjetëse.

⁹ M. Mandalà, "Il Dittionario (1702) di F. M. Da Lecce e i turchismi nell'albanese (sec. XVII-XVIII)", *Albanica* 10, Quaderni dell'Istituto di Lingua e Letteratura Albanese, Palermo, 1995, f. 77.

¹⁰ E. Çabej, "Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes", *Studime filologjike*, nr. 4, 1975, f. 79.

¹¹ G. B. Pellegrini, "Il lessico dell'arbëresh e i turchismi", në: *Le minoranze etniche linguistiche*, Atti del II Congresso Internazionale, Piana-Palermo, 1989; khs. M. Mandalà, "Il Dittionario...", art. i cit., f.41.

¹² T. Dizdari, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, Tiranë, 2005.

¹³ G. Meyer, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Çabej, Tiranë, 2007.

¹⁴ E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, II, 1976; III, 1987; IV, 1996; V, 2014; VI, 2002; VII, 2006.

1. Shtëpia, orenditë shtëpiake, almiset (17 njësi)

çardak, këtu: “kullë”: I 2 5 me dyer të bukura, *çardaqe* fort të nalta, (le *torri altissime*); *çekiç*: II 118 5 e me të rrafuna të mëdha të *çekiçavet*, depërtuenë duertë; *hajat* “treme: it. portico”: I 75 14 Përjashtane ngjiturë për kishet ishinë *hajatetë*; *hallat* “vegël”: I 1 4 Nji shtësë kaqa e vogëlë me pasunë shqise e *hallate* të mposa; *hambar* (Bardhi); *koç* “qerre”: XVII tue më lëshuem ndë Padovët shtëpi, trimëni, kual e *koç*; *konak* “banesë, bujtinë”: II 33 2 e ma tepërë kur pëveti *konak* Xakeut. (it. quando addimandò *albergo* à Zacheo); *ku*: II 89 20 ata qi epinë lëmoshënë ndë *ku* për trajtim të kishësë; *oxhak*: I 68 19 Duketë ndë *oxhakt* i katërti mbë gasë të t'birrit; *qilër* “qilar”: I 160 1 ruheshinë ndë *qilërtë* o kujer të Rom. (si conservavano nell'Archivio di Roma); *qyshk* “qoshk: lat. angulus”: I 112 8 Bam mbë krye të *qyshkut* “facta est in caput anguli”, Dizdari *qoshk* nga turq., por te Pianigiani jepet trajta pers. *kushk*; *saraj* “pallat”: I 102 24 Aty tue shetitunë nji ditë ndëpër *saraj* të vet; *senxhir* “zinxhir”: I 24 19 tash është lidhunë, e atëherë ka me dalë senxhirit (edhe Budi e Bardhi); *sexhade*: II 111 11 Pilatinë; i sillu ndenj mbë *sexhadet*, (sedette nel Tribunale); *syngjyer* “sfungjer”: II 120 10 prashtu muerrë nji *syngjyer* plot me uthullë; *tepsi* “enë e madhe bakri”: I 30 50 Andaj bijenë lodërtivet, *tepsivet*, shtienë pushkë (Buzuku, Bardhi); *terez* “peshore”: II 11 2 Aso koheje kur dita e nata mbë *terez* janë të njimendë (Budi); *tullë*: I 86 3 për urdhënit të Faraonit banke *tullë* e të tjera punë të liga.

2. Veshjet, ngjyrat (8 njësi)

bylezik “byzylyk”: II 47 3 kje aqa i madh sa bylezikëtë e së shoqesë i shërbejinë për unazë; *bojë* II 103 12 birrë tand aqa ndërruem ndë faqe, ndërruem *boja* e bukurë; *i bojadisunë* “me ngjyra”: II 7 10 Kurraj nukë veshi petëk të *bojadisunë*; *leqe* “njollë” < turq. *leke*: I 159 1 Lum, o dru e bukura, e pa ndonji leqe; *mavi* “i kaltër”: II 119 6 e mbë tã bajtëke nji qurdie *mavi*; *qurdie* “mantel” (ndoshta nëpërmjet serb. *çurdiya* prej turq./pers.): II 119 6 e mbi tã bajtëke nji *qurdie* mavi; *saftian* “lëkurë e hollë e e butë”: L. Bogdani XLVIII Grigja të njehunë s'ka, / Lesh e *saftian* e dyllë; *tereqe* “pallto”: II 41 12 me nji *tereqe* të përunderunë ndjerë përdhe (Meyer; s'e ka Dizdari).

3. Terminologjia ushtarake e administrative (11 njësi)

bajrak “flamur”: II 108 4 tue pritunë të çtjellë *bajrak*, e të banjë me ram borivet; *bor*: I 173 3 *Boria* prej qiellshit nji za të përmallshim ka me shtim; *dimisq* “damaskine, shpatë a thikë Damasku”: XLVIII /Gjithë nd'armë mbukuruem, / Prej Gore *dimisq* (Lukë Bogdani, vjersha); *gem* “anije: it. vascello”: I 142 1 Andaj tue votë prej breg detit, hini ndë *gem*

(it. *s'imbarcò*); *haraç* "taksë, detyrim: it. tributo" II 19 3 qi gjithë rajeja e perendisë tinaj, ..., të shkruhej ndë giobë o *haraç* (edhe Bardhi); *mehqeme* "gjykatë" I 130 2 e për të shqyrëtuem ma mirë këtë godi vonë ndë *mehqemet* (andarono nella *sala del Giudicato*); *mejdān* "shesh; shesh luftimi; dyluftim, bejleg, duel: it. *diffida*": I 98 6 asgjamangu nukë guxonte kush me dalë ndë *mejdān* me atë të përbim; *sejmen* "ushtar: it. soldato": I 102 22 Prashtu vote Davidi me gjashtëqind *sejmen* ke regji i Getit; *shator* ~ *shatorr* "çadër fushimi: it. *padiglione*; banesë e vogël: it. *abitacolo*": I 35 12 këtë *shator* të madh të qiellit (it. *padiglione*) Dizdari për turqizëm, Çabej: e dyshimtë a hungarisht a turqisht¹⁵, por me gjasë mund të ketë hyrë edhe nga serbishtja. (E ka edhe Buzuku); *testīr* "leje": I 71 4 e dha *testīr* me trajtuem përsëri Kishënë; *vergī* "taksë: it. tributo": I 85 1 Ma para me *vergī* të mëdha e me mund.

4. Profesione, tituj, zeje (25 njësi)

çelepī "bujar, fisnik; i qytetëruar": XLVII /Prizërenë *çelepī*,/ Gjithë nd'armë mbukuruem; *dadē* "shërbëtore: it. *damigella*, *serva*": II 103 13 kaleth u avit një *dadē* e shtëpisë; *gytërim* ~ *gyturim* "sakat": II 55 17 bajtëkeshinë mbë viq një nieri *gyturim* e paralitik; *dervish* : II 41 13 U shti Djalli se po vinte si një *dervish* së largu; *hadum* "hadëm, eunuk": I 129 1 urdhënoj Asfenecit qefalisë *hadumet* vetë; *hajn* "rebel, kaçak": Përgjegji Zoti Jank O i pafe, *hajni* i Tinëzot gjithëpushtueshimit (edhe Bardhi); *hesap*: II 19 3 Mbasi rrodhnë mb atë mëndyrë, o *hesap* bam ndë jetë të shekullit (edhe Bardhi); *horjat* "i pagdhundur: it. *rustico*, tur. "njeri malok, kaba, që s' i vjen gjë për doresh": I 2 5 i silli *horjat* e i marrë menç kish me u gjetunë (edhe Bardhi); *hoxhë* II 107 1 ndër ta ishinë shumë gjind të kuvendit, *hoxhë*, skribë e farizej; *kasap* II 134 17 e si një delezë qi po e shpijnë ndër *kasapë*; *konakçī* "bujtinar": II 79 26 u da, e la *konakçīsē* penezë për sa duhej ati t'plaguemi; *kusar* "hajdut": II 46 3 Milloni *kusar* i fortë kje dy kutash së vetëmi i madh, dhe derivatet *kusëri*, *kusëruem*; *myftī* ~ *muftī* "klerik i lartë: it. *pontefice*": II 85 2 tue kjanë *myftī*, ndonë ishte i përkatënuem; *nazër* "qeveritar turk; ministër": XVII zû *nazëri* i Shkupsë fort me më përzanë - Dizdari *nazir* "mbikqyrës, në Turqi edhe ministër"; *pashë* I 43 15 se ma i vobek kje Vuça *Pasha*; *qehajé* "mëkëmbës: it. luogotenente": Pleqënia e shtëpisë Bogdananjet tue bajtunë barrën' *qehajesë* Despotit Shërbisë; *raje* "i nënshtuar i një feudali: it. *vassallo*": II 34 5 Si munë jetë se ende jemi *raje* e tjetër dheu?; *refasi* turq. "një fraksion

¹⁵ E. Çabej, "Për një shtresëzim kronologjik të huazimeve turke të shqipës", SF, 1975/4, f. 83.

i sektit shiit”: I 19 3 ajo dorë turish qi u thonë *Refasi*; *sabit* në: *pa bām sabit* II 107 2 “*senza provarlo*”: II 107 2 mue nuk’ashtë dhanunë me ligj të Romësë pa bām *sabit*, me kondënuem mbë mort. (it. senza provarlo), khs. turq. *sabit* “i qëndrueshëm, i ngulët”, ndoshta me kuptimin “pa dhënë prova të qëndrueshme”. *sanxhak* “qeveritar i një sanxhaku, sanxhakbej; it. sangiacco” I 34 9 Nji upeshkëp pëveti *sanxhaknë* Shkodërsë (edhe Bardhi); *shatër* “shërbëtor i ri i një fisniku: it. paggio”: I 102 23 i silli *shatërë* shpu kumëtitë Davidit; *terzi* “rrobaqepës”: I 177 1 e kësi vjeti gjet Kaini zanatin e *terzivet*; *vezir* “pasha; kryeministër”: II 30 15 gazëmend, qi nukë kanë perenditë e *vezirëtë*; *xhelat* “ekzekutor; vrasës, mizor”: II 113 19 ata *xhelata* e shpunë Jezu Krishnë me kryqësuem; *zanat* I 177 1 e kësi vjeti gjet Kaini *zanatin* e *terzivet*.

5. Toka, vendbanimet, qyteti (2 njësi)

bahçe “kopsht”; *meçite* “tempull”: Dizdari *mesxhit*. Në Mjedën e Epërme ka qenë *meçiti* “vendi ku mblidhen turqit e Zadrimës çdo të premtë” (BUST II, 1956, 165, Relac. mbi F. Bardhin). Përdorur së pari nga Bogdani në letërsi.

6. Bimët e kafshët (4 njësi)

devë; *selvī* “qiparis”; *fil* “elefant”; *quhejlanë* “pelë” - Dizdari qyhelan “kal race gjaku së kulluet arab”.

7. Mallrat, metalet, xehet (3 njësi)

billur “kristal”; *tuç* “tunxh”; *xehë* (*cehë*) “minierë”

8. Feja, kombësia (3 njësi)

bullë e. f. “grua myslimane”, turq. *bula* “teze”; *urum* “shtetas grek ortodoks në perandorinë osmane”; *tatar* “tartar” - Dizdari: turq. tatar.

9. Higjena, mjekësia (2 njësi)

jakī “djegje e plagës me hekur të nxehtë a me lëndë gërryese: it. cauterio”; *synet* “rrethprerje”.

10. Marrëdhënie shoqërore (12 njësi)

amanat “amanet”; *me begenisunë* - Dizdari: bejendis; Budi: *begënī* “specialmente”, *mnyr ma begënisun* “maniera più speciale”; *davī* e. f. “grindje, çështje për t’u zgjidhur, dava” (Bardhi); *hatër* “dashamirësi: it. affetto”; *hile*; *me kondisunë* “strehoj, përbuj” < turq. konmak “banoj”; *kurban* “fli, therore”; *mahanë* “sebep, shkak i kotë, pretext”; *mëhyr* “vulë”; *me myhërlisunë* ~ *myhurlisunë* - Dizdari: myhyrletis etj.; *nasip* “fat: it. destino” (barbarizëm). S’e ka Dizdari. *zaptoj* “pushtoj” < zap, turq. zapt, Dizdari.

Midis turqizimave të Bogdanit hasen edhe tri folje: *me begenisunë* “miratoj: it. approvare; comprovare”, *me kondisunë* “strehoj, përbuj”, *me*

myhërlisunë “vulos: it. *sigillare*”. Këto janë formuar nga preteriti turk në vetën III me *-di*: *beyendi, kondi, mühürledi*¹⁶, sipas rregullit të përshtatjes së foljeve të turqishtes në shqip¹⁷.

Disa fjalë me prejardhje turke që gjenden te fjalori i Bardhit, pra kishin hyrë në gjuhën shqipe, nuk janë përdorur nga Bogdani në veprën e tij. Një arsye për këtë mund të jetë se ato fjalë në atë kohë nuk ishin përgjithësuar ende në të gjitha nivelet e gjuhës, por ndoshta ka qenë edhe një zgjedhje e vetëdijshme për të parapëlqyer fjalën vendase që ekzistonte në gjuhë. Ankesa e Frang Bardhit për gjuhën shqipe që “po bdaretë e po bastardhohetë sã mã parë të ve” aludon në radhë të parë për depërtimin në masë të turqizimeve dhe ky nuk mund të mos ishte shqetësim edhe për pasardhësit e tij, jo vetëm si priftërinj katolikë por edhe si atdhetarë pararendës të Rilindjes kombëtare shqiptare. Por arsyeja më bindëse ka të bëjë me karakterin letrar e dituror të gjuhës së përdorur prej tij në përshtatje me natyrën kryesisht teologjike e fetare të veprës, ku turqizmat popullorë tingëllojnë si shfaqje të rrafshit ligjërimit në një tekst që mëton të ruajë nivelin e ngritur letrar. Kështu Bogdani përdor *i lajm* për “i dërguar, lajmëtar”, të cilën Frang Bardhi e ka në fjalorin e tij krahas turqizmit *elçî*. Për drejtuesin e grigjës, qoftë në kuptimin konkret qoftë në atë shpirtëror, përdor vetëm fjalën vendase *barî*, ndërsa Bardhi ka *barî* për “pastor” dhe *çoban* për “pecorarius”. Turqizmi *aksham* nuk haset në asnjë rast në tekstin e Bogdanit, ku zotëron vetëm *mbramje*. Ndonjë turqizëm si *daulle*¹⁸ duket se në shekullin XVII nuk ka hyrë ende në shqipen e Veriut, pasi mungon jo vetëm tek Bogdani dhe paraardhësit e tij, por edhe te

¹⁶ Shih T. Dizdari, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, Tiranë, 2005, f. 88, 552, 683.

¹⁷ Shih p.sh. G. Meyer, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, vep. cit., f. 250; E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, vëll. V, K-M, Botime Çabej, Tiranë, 2014, f. 117; T. Dizdari, *Fjalor i orientalizmeve*, f. 567.

¹⁸ Çabej (“Për një shtresëzim kronologjik të huazimeve turke të shqipes”, art. i cit., SF, 1975/4, f. 83) e jep këtë fjalë për arbërishten si huazim i hershëm, por fjalori i Giordanos (*Fjalor i Arbëreshvet t’Italisë*, Edizioni Paoline, Bari, 1963, f. 67) këtë fjalë e ka nga De Rada, i cili përdorte rëndom fjalë nga shqipja e dheut mëmë, pra nuk është i sigurt si huazim i vjetër.

shkrimet e fillimit të shekullit XVIII si Fjalori i Da Lecces¹⁹ dhe Kuvendi i Arbënit²⁰. Në vend të saj përdoret *lodërti*.

Në periudhën e Rilindjes, në lidhje të ngushtë me përpjekjet për pavarësi nga Perandoria Osmane, u bë një luftë sistematike edhe kundër turqizimeve në gjuhë, duke i zëvendësuar ato me fjalë nga gjuhë të Evropës ose me neologjizma të krijuara me brumin e shqipes. Në këtë pikëpamje puna e autorëve të vjetër të Veriut për pasurimin e leksikut të shqipes dhe kujdesi i tyre ndaj gjuhës shqipe është shtrati i patharë kurrë, nga i cili mbinë më se një shekull më vonë farat e shëndosha të Rilindjes kombëtare.

¹⁹ *Át Francesco Maria da Lecce O.F.M. Dittionario Italiano-Albanese (1702)*. Botim kritik me hyrje dhe fjalësin shqip përgatitur nga G. Gurga, Botime Françeskane, Shkodër, 2009.

²⁰ B. Demiraj, *Dictionarium Latino-Epiroticum (Romae 1635) per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.